



Prishtinë: 30.09.2011

Kodi i ZRRE-së: V_372_2011

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_622_07_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_622_07_11**;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2011 nxori këtë:

VENDIM

APROVOHET ankesa e konsumatorit N.N.T "Tregtia", me shifër DPR – 90014016

(konsumatori i grupit tarifor 3) konsumatori nga Fushë Kosova, si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 21.09.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK-ut – Departamentit për Konsumator të datës 20.07.2010, lidhur me kontestimin e tij ndaj faturës 03/2008.

- Me datë 11.01.2008 punëtorët e autorizuar për leximin e pikave matëse të KEK-ut kanë lexuar pikën matëse të konsumatorit në shifrën DPR – 90014016, ku kanë përpiluar procesverbalin-protokollin nr. 0012180 si dhe kanë regjistruar të dhënat teknike të grupit matës.
Provë: Procesverbali - protokoli i KEK-ut nr. 0012180 i datës 11.01.2008
- Me datë 14.01.2008 Divizioni i Rrjetit në Prishtinë ka lëshuar pëlqimin energjetik për konsumatorin N.N.T "Tregtia", adresa: Fushë Kosovë-Prishtinë objekti-Veprimtaria: Bazë e prodhimit të betonit.
Provë: Pëlqimi elektroenergjetik i lëshuar me datë 14.01.2008
- Bazuar në kërkesën e konsumatorit Menaxheri i departamentit për zgjerim të rrjetit dhe lidhjeve të reja, ka lëshuar shkresën me të cilin kërkohet që të bëhet pranim-vulosja e grupit matës bazuar në pëlqimin elektroenergjetik lëshuar me datë 14.01.2008 si dhe kushteve të përcaktuara sipas pëlqimit elektroenergjetik.
Provë: Shkresa zyrtare e KEK-ut e datës 04.02.2008
- Me datë 19.02.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë regjistruar të dhënat teknike të grupit matës: njehsorin elektrik nr. 35552608.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 1563 i datës 19.02.2008
- Me datë 28.12.2006 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit (Gradilishte Prishtina Kosova-Vushtrrisë) me shifër DPR - 90014016 si dhe kanë konstatuar se borxhi i kontestuar është 5,009.71 €.
Provë: Formulari për kontestimin e borxhit DCF01 i datës 28.12.2006



- Me datë 10.03.2008 konsumatori N.N.T "Tregtia" është ngarkuar nga KEK-u me faturë mujore 020862209DPR-90014016 në vlerë 12,032.45 €.
Provë: Fatura 020862209DPR-90014016 në vlerë 12,032.45 €
- Pas kësaj konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar faturën e periudhës 02/2008.
Provë: Ankesa e konsumatorit
- Me datë 20.07.2010 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në pasqyrën e shpenzimeve si dhe vlerën e kontestuar sipas AKM.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 20.07.2010
- Me datë 21.09.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut dhe konsumatori, ka vërejtur se;

- ✓ Me datë 11.01.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për leximin e pikave matëse kanë lexuar pikën matëse të konsumatorit në shifrën DPR – 90014016 kanë përpiluar Procesverbalin-Protokollin nr. 0012180 si dhe kanë regjistruar të dhënat teknike të grupit matës. Bazuar në të dhënat e evidentuara konstatohet se konsumatori ka bërë ndërrimin e njehsorit si dhe ka vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 35552608 me gjendje (Aktiv: tarifa e lartë - TL=930.29 kWh dhe tarifa e ulët - TU=1160.95 kWh; Reaktiv: tarifa e lartë TL=924.79 kVar dhe tarifa e ulët - Tu=1074.24 kVar). Në të njëjtin procesverbal është evidentuar edhe gjendja paraprake shpenzimit me njehsor të ri por që nuk është dokumentuar nga KEK sha leximi i mëhershëm i shpenzimit (gjendja paraprake: Aktiv: tarifa e lartë - TL=888.07 kWh dhe tarifa e ulët - TU=1094.17 kWh; Reaktiv: tarifën e lartë - TL=904.83 kVar dhe tarifa e ulët - TU=1048.34 kVar).
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0012180 datë 11.01.2008
- ✓ Divizioni i Rrjetit në Prishtinë me datë 14.01.2008 ka lëshuar pëlqimin energjetik për konsumatorin N.N.T "Tregtia", adresa: Fushë Kosovë-Prishtinë objekti-Veprimtaria: Bazë e prodhimit të betonit. Në pëlqimin elektroenergjetik janë të përshkruara edhe kushtet energjetike të cilat kompania i ka plotësuar si dhe kushtet të cilat kompania duhet ti plotësoj brenda afatit ligjor për kyçje në rrjetin e distribucionit.
Provë: Pëlqimi elektroenergjetik lëshuar me datë 14.01.2008
- ✓ Bazuar në kërkesën e konsumatorit, Departamenti për zgjerim të rrjetit dhe lidhjeve të reja, ka lëshur shkresën me të cilin kërkohet që të bëhet pranim-vulosja e grupit matës bazuar në pëlqimin elektroenergjetik lëshuar me datë 14.01.2008 si dhe pagesës së bërë nga konsumatori për kyçje në rrjetin elektrik.
Provë: Shkresa zyrtare e KEK-ut e datës 04.02.2008
- ✓ Me datë 19.02.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë regjistruar të dhënat teknike të grupit matës: njehsorin elektrik nr. 35552608 si dhe kanë vulosur me vulë distributive nr. 20071676. Bazuar në të dhënat e evidentuara konstatohet se konsumatori ka bërë ndërrimin e njehsorit ku ka larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 3777047 si dhe ka vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 35552608 me gjendje (Aktiv: tarifa e lartë - TL=982.86 kWh/muaj dhe tarifa e ulët - TU=1283.37 kWh Reaktiv: tarifa e lartë - TL=962.65 kVar dhe tarifa e ulët - TU=1116.24 kVar). Ekipi montues po ashtu ka shqyrtuar edhe TMRR të cilët janë 150/5 A ashtu si



parashihet me pëlqimin elektroenergjetik si dhe kanë vulosur të njëjtit me vula distributive nr. 20071073, 20071074 dhe 20071075.

Provë: Procesverbali i KEK-ut mbi ndërrimin e grupit matës nr. 1563 i datës 19.02.2008

- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 28.12.2006 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit (Gradilishte Prishtina Kosova-Vushtrrisë) me shifër DPR - 90014016 si dhe kanë konstatuar se borxhi i kontestuar sipas AKM është 5,009.71 € dhe se është bërë prerja e borxhit, por që punëtorët e KEK-ut nuk kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr. 3777047, gjë për të cilën është dashur të merret edhe gjendja e njehsorit elektrik.

Provë: Formulari për kontestimin e borxhit DCF01 e datës 28.12.2006

- ✓ Me datë 10.03.2008 shifra DPR - 90014016 (Gradilishte- Prishtinë Kosovo-Vucitrn) është ngarkuar nga ana e KEK-ut me faturë mujore 020862209DPR-90014016 në vlerë 12,032.45 €. Kjo faturë i është ngarkuar konsumatorit si pasojë e mospërputhjes së gjendjes reale të shpenzimit të regjistruar në njehsorin nr. 3777047 pas ndërrimit të njehsorit me gjendjen e fundit të faturuar në periudhën 11/2002.

Provë: Fatura020862209DPR-90014016 në vlerë 12,032.45 €

- ✓ Bazuar në transaksionet e konsumatorit konstatohet se shifra DPR - 90014016 (Gradilishte-Prishtinë Kosovo-Vucitrn) është ngarkuar me shpenzime deri në periudhën 11/2002 dhe se nga periudha 11/2002 deri më 02/2008 kjo shifër ka qenë i pasivizuar, ngase nuk ka asnjë faturë e energjisë elektrike gjatë kësaj periudhe. DMK ka kërkuar nga KEK sha që të ofroj faturat e energjisë elektrike para periudhës 12/2002 për të parë gjendjen e shpenzuar në njehsorin e vjetër dhe se sipas atyre faturave të siguruara nga KEK-u konstatohet se konsumatori në periudhat e me hershme (08/2002, 09/2002, 10/2002 si dhe 11/2002) është ngarkuar me faturim pa matje dhe se gjendja e fundit e faturuar ka qenë **TL=10,904.93 kWh** dhe **TU=6,229.98 kWh**.

- ✓ Bazuar në listat e leximit të ofruara nga KEK sha për periudhën 12/2007 dhe 01/2008 konstatohet se lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se nuk ka qasje në pronë dhe se konsumatori Gradilishte- Prishtinë Kosovo-Vucitrn nuk mund të gjendet, por që në periudhën 03/2008 ka evidentuar shpenzimet e konsumatorit të ri NNT Tregtia "Baza e prodhimit të betonit".

Provë: Listat e leximit të KEK-ut periudha 12/2007-01/2008 dhe 03/2008

- ✓ Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe transaksioneve të konsumatorit konstatohet se konsumatori nga periudha 12/2002 deri më 02/2008 nuk ka pasur fare shpenzim të energjisë elektrike përkatësisht ka qenë pasiv kurse për periudhën 08/2002 deri më 11/2002 konsumatori nuk ka lexim përkatësisht është ngarkuar pa matje.

Provë: Rrjedha e energjisë elektrike dhe transaksionet

- ✓ Konsumatori N.N.T Tregtia me pronarë Bedri Prishtina ka ofruar dokumente nga Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) apo Agjensioni Kosovar për Privatizim (AKP) e tanishme me të cilat vërtetohet se që nga data 23 mars 2006 është pronare apo blerëse e kompanisë "Gradilishte – Prishtinë Kosovo – Vucitrn" e cila deri në atë kohë ka qenë kompani shtetërore dhe e menaxhuar nga AKM. Ky konsumator po ashtu ka ofruar kontratën lidhur me datë 13.09.2002 mes kompanisë NSH "Kosova" dhe kompanisë NP "LON-DON COM" nga Prishtina, sipas së cilës kompania NP "LON-DON COM" nga Prishtina do të merret me prodhimin e betonit.

Provë: Shkresat e AKM, e datës 26.03.2006

- ✓ Me datë 23.03.2006 KEK sha bazuar në dokumentacionin e AKM, kontratën mbi shitblerjen e ndërmarrjes shoqërore NSH "Gradilishte – Prishtinë Kosovo – Vucitrn" nga kompania N.N.T



“Tregtia” me qëllim që pronari i ri N.N.T “Tregtia” të lirohet nga borxhi paraprak ka bërë prerjen e borxhit të krijuar deri në periudhën 12/2002 në vlerë 5,009.71€.

- ✓ Konsumatori N.N.T “Tregtia” në ankesën e tij thekson se pas marrjes së pronës nga AKM ka kërkuar nga të gjitha kompanitë publike (ujësjellësi, etj) përfshi edhe KEK-u të bëhet prerja apo evidentimi i shpenzimit të mëhershëm nga kompanitë tjera me qëllim që shifra të kalojë në emër të kompanisë NNT “Tregtia”. Komisioni i KEK-ut pas kërkesës tonë ka vizituar pikën matëse si dhe na ka sugjeruar që të bëhet ndërrimi i njehsorit elektrik, të vendoset njehsori industrial grup matës pasi që i njëjti nuk i plotëson kushtet që edhe me tutje të përdorët për regjistrim të shpenzimit të energjisë elektrike. Deklaratës konsumatori po ashtu i ka bashkangjitur edhe aplikacionin e KEK-ut për kontestim borxhi të datës 13.04.2006 në emër të Shaban Krasniqi, me numër identifikues 2004341727.

Provë: Deklarata e konsumatorit dhe aplikacionin e KEK-ut për kontestim borxhi të datës 13.04.2006

- ✓ Sipas dokumenteve të prezantuara, transaksioneve të konsumatorit, rrjedhës së energjisë aktive, faturave të energjisë elektrike, procesverbaleve të KEK-ut, shkresave të dërguara nga konsumatori kemi vërejtur në procesverbalet e KEK-ut gjendja e njehsorit elektrik nr. 3777047 në ka qenë: tarifa e lartë TL = 10904 kWh dhe tarifa e ulët TU = 8932 kWh. Në faturat e energjisë elektrike të periudhave 08/2002, 09/2002, 10/2002 dhe 11/2002 vërehet se gjendja e njehsorit elektrik nr. 3777047 në periudhën 08/2002 ka qenë: TL=10877 kWh dhe TU=6221 kWh dhe se KEK-u këtë muaj dhe muajve tjerë 09/2002, 10/2002 dhe 11/2002 e ka faturuar me faturim pa matje/paushall. Sipas këtyre dokumenteve nuk mund të vërtetohet se cila ka qenë gjendje reale e fundit e lexuar e njehsorit elektrik nr. 3777047 ngase KEK-u konsumatorin e ka faturuar me faturim pa matje/paushall. Po ashtu sipas dëshmive të paraqitura del se prej periudhës 12/2002 e deri 02/2008 shifra e konsumatorit DPR – 90014016 ka qenë pasive dhe se nuk është faturuar me fatura mujore nga ana e KEK-ut.

DMK pas analizave të bëra dëshmive dhe argumenteve të paraqitura konstaton se KEK sha nuk është dashur të bart borxhin e faturimit mbi dallimin e kWh në njehsorin e vjetër nr. 3777047 tek konsumatori N.N.T “Tregtia” pasi që nga fillimi i faturimit KEK sha deri më 11/2002 nuk ka pasur pasqyrë të saktë të shpenzimit të energjisë elektrike nga kompania NSH “Gradilishte - Prishtinë Kosovo - Vucitrn” pasi që është ngarkuar në mënyrë paushallë /pa matje, andaj ka rekomanduar Bordin e ZRRE-së që të **aprovojë** ankesën e konsumatorit dhe vjen në përfundim se;

1. KEK-u obligohet që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR - 90014016 nga borxhi i ngarkuar si pasojë e faturës nr. 020862209DPR-90014016 në vlerë prej 12,032.45 €.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që të **aprovojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

- Të shkarkojë konsumatorin me shifër DPR - 90014016 nga borxhi i ngarkuar si pasojë e faturës nr. 020862209DPR-90014016 në vlerë prej 12,032.45 €.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar